



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 413 Akti

Nr. 587 Vendimi
Tiranë, më 22.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 10.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Teuta Hoxha**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar me deklaram në seancë nga av. Viktor Gumi.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancën dëgjimore subjektin dhe përfaqësuesin e subjektit të rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Teuta Hoxha është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Teuta Hoxha i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Valbona Sanxhaktari dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Teuta Hoxha, bazuar në kriterin e rivlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për marrjen e provave e thirrjen e dëshmitareve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 12.10.2022 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për kriterin e pasurisë, për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 24.10.2022.

6.1. Komisioni është njohur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kohë shtesë për marrjen e provave në Mbretërinë e Bashkuar. Në përgjigje të kërkesës, Komisioni ka njoftuar subjektin se ka shtyrë afatin për të paraqitur provat, deri në datën 31.10.2022.

6.2. Komisioni është njohur me kërkesën e dytë të subjektit të rivlerësimit për kohë shtesë, për marrjen e dokumentacionit të referuar si provë e domosdoshme për finalizimin e shpjegimeve të saj dhe e njoftoi subjektin se ka shtyrë afatin për dërgimin e shpjegimeve të plota dhe provave që referon deri në datën 7.11.2022. Subjekti depozitoi shpjegime dhe dokumentacion provues në përgjigje të barrës së provës, brenda afatit të caktuar, si dhe vijoi të dërgojë shpjegime e prova deri në datën 18.11.2022, të cilat u administruan dhe u analizuan nga Komisioni.

6.3. Në shpjegimet e dhëna, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit Teuta Hoxha i paraqiti trupit gjykues kërkesën për riçeljen e hetimit dhe përfshirjen në të edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

6.3.1. Trupi gjykues, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, pasi për komponentin e pasurisë provat kanë nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

6.4. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Teuta Hoxha vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale.

I. SEANCA DËGJIMORE

7. Në datën 10.11.2022, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

7.1. Në përfundim të seancës dëgjimore trupi gjykues ftoi subjektin të shprehte qëndrimin e saj përfundimtar për procesin e rivlerësimit. Subjekti kërkoi çelje të hetimit administrativ për dy

kriteret e tjera: kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në vijim, trupi gjykues u tërhoq për vendim.

7.1.1. Trupi gjykues, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë kërkesën e bërë nga subjekti i rivlerësimit, në seancën dëgjimore, pasi për komponentin e pasurisë provat kanë nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

7.2. Seanca për shpalljen e vendimit të trupit gjykues u zhvillua në datën 22.11.2022.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

8. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit Teuta Hoxha, ku në përfundim ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

8.1. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

8.2. Subjekti i rivlerësimit Teuta Hoxha, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, pasi ushtron detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që prej vitit 2000.

8.3. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore (DPV) dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur me të, ku ka rezultuar si vijon:

i. Apartament me sip. 91 m², në rrugën “*”, Tiranë, në përdorim nga subjekti i rivlerësimit nga viti 2001**

9. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *apartament me sip. 91 m² (i ndërtuar në vitin 1977) ndodhur në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, në përdorim. Si pronar të pasurisë nr. pasurie *** ka deklaruar z. H. K., babai i bashkëshortit L. K. Kontrata e blerjes nr. ***, datë 10.4.2001. Vlera e blerjes: 1.950.000 lekë. Burimi i krijimit: (i) kontributet financiare të pjesëtarëve të familjes H. K.; (ii) të ardhurat nga puna ndër vite; (iii) shpërblime nga përfitimet e statusit të të përndjekurve politikë.*

9.1. Bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni mori në shqyrtim deklaratën periodike ndër vite të subjektit të rivlerësimit, ku i rezultoi se nuk kishte qenë korrekte në deklarimin e përdorimit të kësaj pasurie. Në disa deklarata vjetore nuk e kishte deklaruar përdorimin dhe në disa kishte deklaruar marrëdhënie qiraje dhe pagesë të qirasë¹. Komisioni

¹Në deklaratën e interesave private për herë të parë në vitin 2003 ka deklaruar si adresë banimi këtë apartament banimi, nuk ka deklaruar nëse e ka në përdorim apo në pronësi këtë pasuri; në DPV/2004 deklaroi të njëjtën adresë banimi dhe deklaroi qira

vërejtë se subjekti nuk e kishte deklaruar marrëdhënien me këtë pasuri në përputhje me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile informon Komisionin se shtetasit H. Xh. K. dhe S. Z. K. figurojnë të jenë të regjistruar banorë në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Administrative Burrel, Bashkia Mat.

9.2. Në procesverbalin datë 20.10.2004 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: *“Nuk disponoj pasuri të paluajtshme as unë, as bashkëshorti, jetojmë me qira në rrugën ‘***, p. ***, Tiranë, qiraja mujore 20.000 lekë”*. Si dokumentacion provues ka depozituar pranë ILDKPKI-së deklaratën noteriale datë 25.10.2004, të deklaruesit A. K. (kunati i subjektit), i cili ka deklaruar se: *“Prej muajit tetor 1999 deri në gusht 2003 kam qenë emigrant në Mbretërinë e Bashkuar së bashku me motrën dhe dy vajzat e saj. Të ardhurat që merrnim nga puna dhe asistenca i dërgonim në Shqipëri për ruajtje të vëllait tonë L. K. Me këto të ardhura kemi blerë dy banesa, një të bashkuar dhe një të veçantë të regjistruar në emër të babait tim H. K.) dhe tjetrën e ka blerë motra. Në banesën që kam blerë unë banon me qira vëllai im L. K. dhe familja e tij. Unë jetoj në banesën që ka blerë motra ime, e cila vazhdon të jetë në Mbretërinë e Bashkuar”*.

9.3. Në procesverbalin datë 3.6.2008 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: *“Vazhdojmë të jetojmë në të njëjtën shtëpi të deklaruar edhe më parë, por për vitin 2007 nuk paguajmë qira në marrëveshje me familjarët, pasi apartamenti është në pronësi të vjehrrit”*. Në procesverbalin datë 22.4.2015 të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: *“Në pronësinë time dhe të bashkëshortit, ashtu siç kam deklaruar në deklaratimet e mia, nuk disponoj apartament banimi. Jetojmë në shtëpinë e vjehrrit”*.

9.4. FSHU-ja informoi Komisionin se shtetasi L. H. K. dispononte dy kontrata të furnizimit në instancën Tiranë, njëra kontratë me adresë: rruga “****”, Tiranë.

9.5. UKT-ja informoi Komisionin dhe vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës në lidhje me shtetasin L. H. K., i cili disponon kontratat: (i) nr. ***, për objektin me adresë – rruga “****”, Tiranë, me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë; (ii) nr. *** ishte hapur në datën 30.9.2004. Dokumentacioni për kontratën nr. *** (dosje ndryshim emri), ku sipas autorizimit shtetasi H. K. autorizonte djalin e tij L. K. që të bënte ndryshime në librezat e ujësjellësit, duke i kthyer në emrin e tij.

9.6. Subjekti, në pyetësin nr. 2, deklaroi: *“Në deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 25.10.2004, z. A. K. ka deklaruar se të ardhurat e tij për të blerë këtë banesë janë të fituara nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar. Nuk mund të definoj një ndarje të saktë të shumave, por sipas disa vërtetimeve të të ardhurave rezultojnë: të ardhura nga paga L. K., viti 2000 - mars 2001, në shumën 146.079 lekë; të ardhura nga asistenca për vitin 2000 në shumën 24.900 lekë; të ardhura nga qiradhënia e tokës 1.7.2000 – 1.1.2001, në shumën 30.000 lekë; të ardhura nga kapari për shitjen e tokës bujqësore në shumën 1.200.000 lekë. Për të ardhurat nga shpërblimi si përfitues i statusit politik, letra me vlerë dhe bono privatizimi, nuk kam mundur të marrë konfirmimin për periudhën në fjalë”*.

9.7. Në lidhje me realizimin e kontratës së shitjes për sipërfaqen e tokës bujqësore, subjekti ka deklaruar se: *“Toka, objekt i marrëveshjes, ka qenë në proces regjistrimi dhe kontrata e shitjes*

vjetore në shumën 240.000 lekë; në DPV/2005 deklaroi po këtë adresë, me qira vjetore 200.000 lekë; në DPV/2006 deklaroi të njëjtën adresë me qira vjetore 200.000 lekë; në DPV/2007 nuk deklaroi adresë banimi dhe as detyrime për qira; në DPV-të e viteve 2008 dhe 2009 deklaroi adresë banimi: rruga “****”, p. ***, nuk deklaroi vlerë qiraje; në DPV/2010 nuk deklaroi adresë banimi dhe vlerë qiraje; në DPV/2011 deklaroi si adresë banimi këtë pasuri, nuk deklaroi vlerë qiraje; në DPV-të e viteve 2013 – 2016 nuk deklaroi as adresë banimi e as vlerë qiraje; në DPV/2017 deklaroi të njëjtën adresë banimi dhe nuk deklaroi vlerë qiraje.

nuk mund të lidhej pa u regjistruar, regjistrim i cili është kryer më 30.8.2019. Për shkak se njëra nga anëtarët e familjes bujqësore është e martuar në Itali dhe aktualisht me fëmijë të vogël nuk kanë arritur të formalizojnë kontratën përfundimtare”.

9.8. Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me mundësinë e blerjes së kësaj pasurie bazuar në burimet e deklaruara nga subjekti, nga e cila duket se shtetasi H. K. dhe familjarët e tjerë të tij kishin një pamjaftueshmëri financiare në shumën 1.171.729 lekë për blerjen e kësaj pasurie apartament me sip. 91 m² dhe përballimin e shpenzimeve jetike.

9.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 91 m² në rrugën “****”, për të vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nuk ndodhet në situatën e parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.10. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: *“Në analizën e Komisionit nuk janë përfshirë:*

- i) Të ardhurat nga dëmshpërblimi i të përndjekurve politikë, nga babai i nënës së bashkëshortit, në masën 400.000 lekë, përfituar me ligjet e mëparshme, ndërkohë në zbatim të VKM-së nr. 1253, datë 2.7.2008, përfitonte 1.840.000 lekë (në lekë dhe letra me vlerë), pasi i janë zbritur shumat e përfituara me ligjet e mëparshme.*
- ii) Të ardhurat nga pensioni i veçantë i nënës së bashkëshortit, znj. S. K., në total ka përfituar 273.822 lekë.*
- iii) Të ardhurat nga qiradhënia e tokës në vlerën 30.000 lekë nga babai i bashkëshortit, sipas kontratës së qirasë datë 1.7.2000, lidhur me shoqërinë ‘****’ sh.p.k.*
- iv) Të ardhurat nga kontrata e kaparit në vlerën 1.200.000 lekë. Kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nuk është finalizuar për arsye se një nga anëtarët e familjes bujqësore jeton në Itali, për arsye objektive nuk ka mundur të vijë në Shqipëri këto dy vitet e fundit. Në muajin gusht 2022 ajo ishte në Shqipëri, por nëna e bashkëshortit u godit nga stroku cerebral dhe ka humbur aftësitë e të folurit dhe të lëvizjes, duke qenë për pasojë në kushtet e pamundësisë absolute për shprehjen e vullnetit. Kontrata e kaparit nuk ka parashikuar ndonjë afat brenda të cilit palët duhet të konkludonin lidhjen e kontratës, gjë që do të ishte e palogjikshme përderisa toka ishte e paregjistruar. Nga ana tjetër, një afat i tillë nuk është përcaktuar edhe referuar momentit pas regjistrimit të pronës, në këto kushte, kontrata e kaparit nuk është zgjidhur dhe, si e tillë, është në fuqi.*
- v) Të ardhurat nga emigrimi të kunatit nuk janë llogaritur saktë, pasi janë hequr shpenzimet e jetës në Mbretërinë e Bashkuar, ndërkohë që ai punonte dhe ushqej në hotel dhe flinte tek shtëpia e motrës së tij. Dokumenti i pagës së muajit korrik 1.7.2003 – 31.7.2003, që tregon edhe të ardhurat progresive për periudhën prill 2003 – 31.7.2003, shumën 4.473,35 GBP nga punëdhënësi G. H. Këto të ardhura nuk janë të përfshira në analizën financiare të Komisionit. Të ardhurat nga paga në muajin maj 2000 në Agjencinë e Punësimit **** nuk janë të përfshira në shumën 548,4 GBP.*
- vi) Të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit për periudhën janar – mars 2001”.*

9.11. Pavarësisht se në deklaratën noteriale nr. **** rep., datë 25.10.2004, z. A. K. ka deklaruar se me të ardhurat e tij të fituara nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar ka blerë

apartamentin në rrugën “****”, në vitin 2001, dhe se kontributi kryesor për blerjen e këtij apartamenti nga familja e bashkëshortit ishte kryesisht e tij, Komisioni analizoi gjithë dokumentacionin lidhur me të ardhurat e të gjithë familjarëve.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

9.12. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar nga hetimi administrativ, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e subjektit dhe përfaqësuesit ligjor në seancën dëgjimore, arsyeton se:

9.13. Në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni ka tagrin që të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo *indicie* apo të dhënë që rezultojnë nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit hetimor të kryer në Komision.

9.14. Në rastin konkret rezultojnë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj të kenë lidhur me këtë pasuri një marrëdhënie huaje të shtrirë në 20 vite, të paformalizuar. Për pasojë, subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, iu kërkua të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

9.15. Referuar shpjegimeve dhe provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, trupi gjykues vlerëson se:

- a. Lidhur me të ardhurat nga dëmshpërblimi si ish i përndjekur politik në vlerën 400.000 lekë, trupi gjykues vlerëson se ato nuk vërtetohen lidhur me kohën kur janë marrë dhe pjesën takuese të shtetasit S. K. dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të përfshihen në analizë si burim i ligjshëm në krijimin e kësaj pasurie.
- b. Lidhur me të ardhurat nga qiradhënia e tokës nga shtetasi H. K. me vlerë 30.000 lekë tek shoqëria “****” sh.p.k., nga verifikimi i kryer në QKB figuron subjekti privat me emër “****” sh.p.k., i regjistruar në vitin 1995 me administrator L. M. Për sa kohë referuar legjislacionit në fuqi qiradhënësi, si person juridik, sipas ligjit ka pasur detyrimin e derdhjes së tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, këto të ardhura në vlerën 30.000 lekë janë shtuar në analizë si burim krijimi për apartamentin në vitin 2001.
- c. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga familjarët e bashkëshortit, trupi gjykues vlerëson se kontrata e kaparit e lidhur për shitjen e tokës në vlerën 1.200.000 lekë nuk është vijuar me lidhjen e kontratës së shitjes dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk përmbushin kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndaj dhe ato nuk janë shtuar si burim krijimi për apartamentin në vitin 2001.
- d. Lidhur me të ardhurat nga puna e vëllait të bashkëshortit, z. A. K., në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti i rivlerësimit solli prova të reja, që dokumentojnë të ardhura nga shoqëria “****” për muajin maj 2000, por këto të ardhura nuk provohen nga informacioni i sjellë nga Zyra e Taksave për vitin financiar prill 2000 – prill 2001, prandaj trupi gjykues vlerëson se këto të ardhura nuk përmbushin kushtet e parashikuara nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndaj dhe ato nuk janë shtuar si burim krijimi për apartamentin në vitin 2001.
- e. Përveç kësaj, subjekti pretendoi për shtetasin A. K. shpenzime jetese më të ulëta se ato të llogaritura nga Komisioni, por asnjë nga këto pretendime të subjektit të rivlerësimit nuk u arrit të vërtetohet me dokumentacion ligjor provues.
- f. Të ardhurat e pretenduara nga pensioni i prindërve për periudhën janar – mars 2001 në totalin prej rreth 29.000 lekësh, janë shtuar si burim krijimi për apartamentin në vitin 2001.

- g. Pas rishikimit të zërave të sa më lartarsyetuar, analiza financiare përfundimtare për pasurinë apartament në datën 10.4.2001 nga të ardhurat nga familjarët e bashkëshortit të subjektit, rezultoi si vijon:

Analiza financiare për blerjen e apartamentin në datën 10.4.2001	Vlera
Të ardhura nga pensioni H. K., 1999 – mars 2001	99,832
Të ardhura nga pensioni S. K., 1995 – mars 2001	234,116
Të ardhura nga pensioni i veçantë S. K., prill 1993 – qershor 1995	23,031
Të ardhura nga qiraja e tokës me shoqërinë “****” sh.p.k.	30,000
Të ardhura nga paga L. K., 1996 – mars 2001	502,041
Të ardhura nga paga dhe papunësia A. K. gusht 1998 – shtator 1999	248,394
Të ardhura nga puna në Mbretërinë e Bashkuar A. K., 2000 – 2001	651,300
Të ardhura totale	1,788,715
Shpenzime jetese	928,345
Blerje apartamenti datë 10.4.2001	1,950,000
Shpenzime totale	2,878,345
Pamundësia financiare	-1,089,631

9.16. Në përfundim, pas hetimit të kryer në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në dokumentacionin e hetimit administrativ, trupi gjykues arriti në përfundimin se të afërmit e bashkëshortit të subjektit nuk kanë pasur burime të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme të përdorur për një periudhë 20-vjeçare nga subjekti i rivlerësimit.

9.17. Përveç këtij fakti, trupi gjykues nënvizon se nga hetimi ka rezultuar se për pasurinë e paluajtshme apartament banimi marrëdhënia e subjektit dhe bashkëshortit të saj ishte disi e pazakontë, për sa kohë familjarët e bashkëshortit kontribuuan me të ardhurat e tyre ndër vite, përfshirë edhe të ardhurat e vëllait nga puna në emigracion për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, e cila në vijim për 20 vjet nuk u përdor prej tyre, por sikundër rezultoi nga hetimi administrativ, u përdor në mënyrë të pandërprerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti.

9.17.1. Nëse trupi gjykues do t’i referohej deklaratës noteriale nr. *** rep., datë 25.10.2004, ku shtetasi A. K. ka deklaruar se ka qenë ai që e ka blerë këtë apartament në rrugën “****” në vitin 2001 me të ardhurat e tij të fituara nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar dhe se aty banonte subjekti dhe bashkëshorti, ndërsa ai banonte te banesa që kishte blerë motra e tij, jo vetëm marrëdhënia bëhej më e pazakontë, por edhe pamundësia financiare e blerjes së këtij apartamenti bëhej edhe më e madhe.

9.18. Gjithashtu, marrëdhënia e subjektit dhe bashkëshortit ishte disi e pazakontë, për sa kohë vëllai i tij, i cili ishte investuesi më i madh për këtë pasuri të paluajtshme, sipas deklaratimit të subjektit, do të kontribuonte me të ardhura hua në vlera të konsiderueshme për blerjen e pasurisë së paluajtshme zyrë në vitin 2008 nga bashkëshorti i subjektit.

9.19. Rrethanat dhe faktet për këtë pasuri si: përdorimi pa ndërprerje, lidhja e kontratës me UKT-në në emër të bashkëshortit të subjektit, investimi nga gjithë familjarët dhe, mospërdorimi i këtij apartamenti nga familjarët për një periudhë 20-vjeçare, çojnë trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit lidhur me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ për këtë pasuri.

9.19.1. Për sa më lartarsyetuar, trupi gjykues vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën faktike të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 5/c të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

9.19.2. Në arritjen e këtij konkluzioni trupi gjykues mban në konsideratë edhe informacionin e rezultuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas së cilës blerësi faktik i kësaj pasurie të paluajtshme, shtetasi H. K., figuronte banor në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Administrative Burrel, Bashkia Mat, dhe informacionin e administruar nga UKT-ja, sipas të cilit bashkëshorti i subjektit ka lidhur në emrin e tij kontratën për këtë banesë. Rrethana të tilla, në mënyrë indirekte, pa u konsideruar spekulative, informojnë trupin gjykues mbi marrëdhënien e subjektit, dhe bashkëshortit të saj me këtë pasuri të paluajtshme.

ii. Apartament me sip. 57 m², në G., Kavajë

10. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *apartament me sip. 57 m², me vendndodhje në G., Kavajë, i paregjistruar në Hipotekë, blerë sipas aktmarrëveshjes datë 21.4.2007, në vlerën 2.100.000 lekë*. Burimi i krijimit: (i) të ardhurat nga puna e saj për vitet 2005 dhe 2006, sipas vërtetimit bashkëlidhur; (ii) të ardhurat nga puna e bashkëshortit për vitet 2005 dhe 2006, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 20.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* aktmarrëveshjen datë 21.4.2007, të lidhur midis shtetasit Y. M., në cilësinë e shitësit, dhe shtetasit L. K., në cilësinë e blerësit.

10.1. Në DPV/2007, subjekti ka deklaruar *apartament me sip. 60 m², në G., Durrës, i paregjistruar në ZVRPP, në vlerën 2.100.000 lekë*. Nuk ka deklaruar burimin për blerjen e kësaj pasurie.

10.2. Shtetasi Y. M. e ka përfituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së datës 10.7.2006, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 30.000 euro. Për shkak të njohjeve të hershme shoqërore që shtetasi Y. M. ka me shtetasin L. K. kanë rënë dakord që këtë apartament t’ia shesë z. L. K. kundrejt çmimit 2.100.000 lekë, si dhe të disa shërbimeve avokatie që z. L. K. (avokat) do të kryejë në interes të z. Y. M..

10.2.1. Nga dosja e ILDKPKI-së ka rezultuar se përveç aktmarrëveshjes së datës 21.4.2007 edhe kontrata e premtim shitjes nr. ***, datë 2.6.2009, e lidhur midis shtetasve Y. M. dhe L. K., sipas së cilës z. Y. M. deklaroi se ka marrë shumën 2.100.000 lekë në datën 21.4.2007 dhe tashmë ai njeh si pronar të këtij apartamenti z. L. K. Gjithashtu, z. L. K. do të kryejë shërbime avokatie për z. Y. M. dhe familjen e tij për një periudhë trevjeçare, që fillon nga data 21.4.2007 deri më 21.4.2010.

10.2.2. Z. L. K. deklaroi se është dakord që veç shumës së mësipërme të kryejë edhe shërbime avokatie për tre vjet rresht në favor të z. Y. M. dhe rrethit të ngushtë familjar të tij, babait dhe vëllezërve.

10.3. Sipas aktmarrëveshjes datë 10.7.2006, lidhur midis shoqërisë ndërtimore dhe z. Y. M., çmimi i apartamentit me sip. 57 m² është 30.000 euro dhe nga porositësi është likuiduar pagesa e plotë jashtë zyrës noteriale.

10.4. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 22.4.2015, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se: *“Nga shuma e shënuar është paguar nga të ardhurat nga puna shuma prej 700.000 lekësh, e paguar në dorë. Pjesa tjetër është shlyer si kompensim i disa proceseve gjyqësore të shtetasit Y. M. dhe familjarëve të tij. Sa i takon mobilimit, apartamenti ka qenë i mobiluar”*.

10.5. Subjekti është pyetur nga Komisioni të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijim e kësaj pasurie. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me likuidimin e çmimit të kësaj kontrate, ju bëj me dije se kam dhënë sqarime edhe më parë kur jam thirrur në ILDKPKI. Sipas procesverbalit mbi shpjegimet në ILDKPKI, datë*

22.4.2015, është likuiduar cash në vitin 2007 vlera prej 700.000 lekësh. Pjesa tjetër është shlyer si kompensim me shërbimet e këshillimit dhe përfaqësimit ligjor në disa procese gjyqësore për z. Y. M. (shitësi) dhe familjarëve të tij. Si prova kam depozituar disa nga vendimet gjyqësore. Gjithashtu po ju vë në dispozicion edhe faturat e shërbimeve, si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 31.1.2022, të deklaruesit Y. M. dhe aktrakordimin datë 14.6.2022, midis Y. M. dhe L. K.”.

10.6. Referuar deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e pagesës së vlerës 2.100.000 lekë në vitin 2007, bazuar në të ardhurat e kursyera të viteve 2005 dhe 2006 dhe fakti që pasuria është blerë në vitin 2007.

10.6.1. Për vitet financiare 2005 - 2006 subjekti deklaroi kursime *cash* në shumën progresive 1.400.000 lekë në fund të vitit 2006.

10.6.2. Në vitin 2007, subjekti nuk deklaroi pakësim të këtyre kursimeve, kështu që këto kursime nga të ardhurat nuk mund të konsiderohen si burim për blerjen e kësaj pasurie.

10.7. Përpos kësaj, këto kursime janë deklaruar në vitin 2008 si burim për blerjen e pasurisë zyrë me sip. 74.5 m², në rrugën “***”, Tiranë. Gjithashtu, nuk konstatohet ndonjë pakësim i kursimeve nga të ardhurat në llogaritë bankare, që të mund të shërbenin si burim për blerjen e pasurisë në vitin 2007.

10.7.1. Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me mundësinë e krijimit të pasurisë apartament me sip. 57 m², në G., Kavajë, si vijon:

Analiza financiare për blerjen e apartamentin në Golem	Vlera
Kursime nga të ardhurat e vitit 2005 - 2006	-
Të ardhura totale	-
Paguar për apartamentin	2,100,000
Pamundësia financiare për blerje apartamenti	2,100,000

10.8. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës, për sa dukej se kishte kryer deklaram të pasaktë në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie dhe ndodhej në pamundësi financiare për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në datën 21.4.2007 në vlerën financiare negative prej 2.100.000 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.9. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: “*Aktmarrëveshja datë 21.4.2007 është një aktmarrëveshje e thjeshtë e lidhur me individin Y. M. dhe nuk është një aktmarrëveshje noteriale e lidhur me shoqërinë ndërtuese. Apartamenti është ndërtuar me leje ndërtimi sipas përshkrimit në përmbajtje të saj. Aktualisht është ende i paregjistruar. Kontrata përfundimtare nuk është lidhur*”.

10.10. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se mes shitësit të ardhshëm Y. M. dhe bashkëshortit të subjektit është mbajtur aktrakordimi datë 14.6.2002, nga ku dakordësohet se çmimi i shlyer është në shumën 2.944.095 lekë. Aktmarrëveshja e thjeshtë e datës 21.4.2007 nuk ka përcaktuar nëse është paguar ndonjë vlerë në çastin e nënshkrimit në këtë datë. Në tërësi, kjo aktmarrëveshje nuk ka ndonjë vlerë ligjore sa i përket të drejtave pasurore të pritshme, pasi nuk është e aftë të sjellë si pasojë, në gjendjen siç është, pronësinë

mbi objektin e përshkruar. Por, nga ana tjetër, kjo marrëveshje ka sjellë një pasojë që nga çasti i dorëzimit të sendit, atë të përdorimit të apartamentit, dorëzuar në çastin e nënshkrimit të saj.

10.11. Në këto kushte, duke e analizuar në të gjithë elementet e saj, marrëveshja e vitit 2007 nuk shpreh në vetvete një marrëdhënie ligjore pronësie, por një marrëdhënie juridike që rregullohet nga të drejtat e detyrimeve. Deklarimi i aktmarrëveshjes datë 21.4.2007, në DPV-në e atij viti, ka referuar në fakt posedimin mbi objektin e përshkruar në përmbajtje të saj. Referuar deklaramentit në deklaratën *Vetting* për apartamentin e përshkruar në përmbajtje të marrëveshjes së datës 21.4.2007 nuk mund të flitet për fitimin e ndonjë pronësie mbi një pasuri të paluajtshme, në kuptim të nenit 195 të Kodit Civil, që përcakton pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi.

10.11.1. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se në aktmarrëveshjen e thjeshtë, jo noteriale, të datës 21.4.2007, citohet: *“Deklarimi në deklaratën Vetting është bërë për shkak të mungesës së kontratës përfundimtare të shitjes me të cilën do të kryheshin edhe rakordimet e shumave të shlyera. Në pyetësorë kam shpjeguar se vlera e paguar në çastin e nënshkrimit të kontratës ka qenë 700.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër është kompensuar me shërbime ligjore. Në procesverbalin e datës 22.4.2015, në ILDKPKI kam deklaruar se nga shuma e shënuar është paguar vlera 700.000 lekë cash, me burim të ardhurat nga puna ime dhe aktiviteti i bashkëshortit. Pjesa tjetër është shlyer si kompensim i shërbimeve të kryera nga bashkëshorti”*.

10.12. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se bashkëshorti i subjektit dhe shtetasi Y. M. kanë hartuar kontratën premtim shitje, me qëllimin që aktmarrëveshjes së datës 21.4.2007, që ishte e thjeshtë, t'i jepej një formë e caktuar noteriale. Gjatë kësaj kohe bashkëshorti kishte vijuar të ofronte shërbime ligjore, të cilat së bashku me vlerën e paguar arrinin në çmimin e fiksuar në aktmarrëveshjen e datës 21.4.2007, fakt ky që duhej evidentuar. Për shkak se apartamenti është i paregjistruar edhe aktualisht, bashkëshorti dhe shtetasi Y. M. kanë nënshkruar aktrakordimin e datës 14.6.2022, në të cilin kanë fiksuar se nuk kanë detyrime që burojnë nga marrëveshja e datës 21.4.2007, depozituar si provë në dosjen e rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

10.13. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramentet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaramentat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramentet në seancat dëgjimore, arsyeton se:

10.14. Pretendimi i subjektit se ka deklaruar në pyetësorë dhe ka shpjeguar se vlera e paguar në çastin e nënshkrimit të kontratës ka qenë 700.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër është kompensuar me shërbime ligjore, fakt ky i deklaruar edhe në procesverbalin e datës 22.4.2015 në ILDKPKI, ku ka deklaruar se nga shuma e shënuar është paguar vlera 700.000 lekë *cash*, me burim të ardhurat nga puna e saj dhe aktiviteti i bashkëshortit, bie ndesh së pari me deklaramentimin e bërë në deklaratën *Vetting* nga ana e subjektit të rivlerësimit, ku vetë subjekti ka deklaruar se çmimi i paguar për këtë pasuri ka qenë 2.100.000 lekë, duke mos deklaruar as kompensimin me shërbimet ligjore nga aktiviteti i bashkëshortit.

10.15. Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës, si dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, trupi gjykues vendosi të konsiderojë dhe

të marrë në konsideratë gjithë dokumentacionin ligjor të hartuar nga palët lidhur me këtë pasuri, në analizim të të cilave arsyetohet si vijon:

10.16. Për sa i përket pretendimit të subjektit se marrëveshja e vitit 2007, sipas së cilës vlera e pasurisë ishte 2.100.000 lekë, nuk shpreh në vetvete një marrëdhënie ligjore pronësie, por një marrëdhënie juridike që rregullohet nga e drejta e detyrimeve. Marrëveshja e thjeshtë bie ndesh me sa parashikohet në kontratën premtim shitje nr. ***, datë 2.6.2009, të nënshkruar nga palët para noterit publik.

10.17. Në përmbajtje të kontratës premtim shitje nr. ***, datë 2.6.2009, palët kanë pranuar dhe deklaruar se midis tyre, siç është parashikuar në aktmarrëveshjen e vitit 2007, çmimi i shitjes do të jetë 2.100.000 lekë dhe veç kësaj vlere z. L. K. do të kryejë shërbime avokatie për z. Y. M. dhe familjen e tij për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar nga data 21.4.2007 deri më 21.4.2010.

10.18. Në përmbajtje të kontratës së premtim shitjes nr. ***, datë 2.6.2009, z. Y. M. deklaron se e ka marrë shumën prej 2.100.000 lekësh që në datën 21.4.2007 dhe që prej kësaj date e në vijim njeh si pronar të këtij apartamenti z. L. K.

10.19. Trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit se ka paguar në datën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes, 21.4.2007, shumën 700.000 lekë, vijnë në kundërshtim me:

- Parashikimet e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve ose për shkaqet e parashikuara me ligj”*.

- Kontratën e përpiluar nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre.

- Parashikimet e nenit 659 të Kodit Civil, ku parashikohet se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

- Parashikimet e nenit 660 të Kodit Civil, ku parashikohet: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

- Parashikimet e nenit 663 të Kodit Civil, në të cilin përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkakun i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e kërkuar nga ligji”*.

10.20. Deklarimet që janë bërë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së në vitin 2015 lidhur me vlerën e paguar të pasurisë, mbeten thjesht në nivel deklarativ dhe nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera faktet e deklaruara që kanë ndodhur realisht.

10.21. Shpjegimi i subjektit se bashkëshorti dhe z. Y. M. kanë hartuar kontratën premtim shitje me qëllimin që aktmarrëveshjes së datës 21.4.2007, që ishte e thjeshtë, t'i jepej një formë e caktuar noteriale, nuk arriti të shpjegojë se përse palët, megjithëse kanë pasur të gjitha mundësitë ligjore të parashikonin sa pretendohet nga subjekti se kushtet e dakordësuara nga viti 2007 kishin ndryshuar, nuk i pasqyruan këto ndryshime në hartimin e dokumentit ligjor të kryerjes së veprimeve juridike mes tyre në vitin 2009.

10.22. Trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën noteriale premtim shitje nr. ***, datë 2.6.2009, të lidhur mes palëve, përfshirë këtu çmimin e parashikuar dhe dakordësuar si të paguar mes palëve dhe deklarimit të palëve se z. Y. M. ka marrë shumën 2.100.000 lekë që në datën 21.4.2007 dhe, në vijim, njeh si pronar të këtij apartamenti z. L. K.

10.23. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit se si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga puna e saj në vitet 2005 dhe 2006, si dhe të ardhurat e bashkëshortit në vitet 2005 dhe 2006, sipas vërtetimit të zyrës së tatimeve, Komisioni arsyeton se:

10.24. Subjekti pretendon se nuk janë marrë parasysh të ardhurat e viteve 2005 - 2006 si burim për blerjen e këtij apartamenti, por kursimet e këtyre dy viteve.

10.25. Në analizën financiare konsiderohen kursimet e një viti nëse ato deklarohen si burim për krijimin e një pasurie dhe jo të ardhurat në total. Këto kursime mund të jenë në llogari bankare ose si kursime *cash*. Referuar deklaratës *Vetting*, burimi i krijimit të kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat nga puna e subjektit dhe e bashkëshortit të saj për vitet 2005 dhe 2006.

10.26. Deri në fund të vitit 2006 subjekti deklaroi kursime *cash* vetëm në vitet 2004 - 2005. Për sa subjektin në vitin 2007 nuk deklaroi pakësim të këtyre kursimeve, këto kursime nga të ardhurat e pretenduara nga subjekti nuk mund të konsiderohen si burim për blerjen e kësaj pasurie, për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i kursimeve të deklaruara në vitin e blerjes së saj nga bashkëshorti dhe subjekti i rivlerësimit.

10.27. Trupi gjykues vlerëson se deklaratat periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit dhe pakësimi i gjendjes *cash* si likuiditet i padeklaruar i pakësuar në vitin 2007 nuk mund të merret në konsideratë. Në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2007 është provë që vërteton rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces për përdorimin e të ardhurave të viteve 2005 - 2006.

10.28. Përdorimi i gjendjes *cash*, që nuk është deklaruar si pakësim, është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen... të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]”*.

10.29. Përveç sa më sipër, këto kursime të pretenduara për vitet 2005, 2006 dhe 2007 janë deklaruar si të përdorura nga ana e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008 si burim për blerjen e pasurisë zyrë me sip. 74.5 m² dhe, sa më sipër, fakti që këto kursime deklarohen prej saj për blerjen e një pasurie të mëvonshme në vitin 2008, rrëzojnë hipotetakisht mundësinë e pretendimit të përdorimit të tyre nga subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2007.

10.30. Gjithashtu, subjekti pretendon se duhen përfshirë si burim i blerjes edhe të ardhurat e vitit 2007 deri në momentin e blerjes, pavarësisht se në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar si burim të blerjes të ardhurat e vitit 2007.

10.31. Në funksion të barrës së provës, subjekti nuk ka depozituar ndonjë provë që mund të ndikojë në analizën financiare në lidhje me mundësinë e blerjes së këtij apartamenti në datën 21.4.2007, duke mos arritur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit se ndodhej në pamundësi financiare për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në këtë datë në vlerën 2.100.000 lekë.

10.32. Trupi gjykues, në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën ligjore të parashikuar nga pikat 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

iii. Zyrë me sip. 74.5 m², në bulevardin “**”, Tiranë**

11. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar zyrë me sip. 74.5 m², e paregjistruar në ZVRPP, me adresë: blv. “****”, rruga “****”, ndërtesa ****, hyrja nr. ****, ap. ****, p. ****, kati i dytë. Kontratë premtim shitje nr. ****, datë 15.6.2008, me vlerë 8.940.000 lekë. Burimi i krijimit: (i) të ardhurat nga puna e bashkëshortit për vitet 2006, 2007 dhe 2008; (ii) gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortit në vlerën 9.000 euro; (iii) gjendje *cash*, krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, paguar nëpërmjet derdhjes në bankë në llogari të bashkëshortit, në shumën 21.000 euro; (iv) huamarrje në shumën 10.000 euro, veprimi nëpërmjet bankës, datë 30.5.2008, me huadhënës K. Ç.; (v) huamarrje në shumën 21.000 USD dhe 13.800 euro (në total 25.000 euro), me huadhënës A. K.; si dhe (vi) huadhënie në shumën 7.980 GBP (afërsisht 10.000 euro), me huadhënës A. M.

11.1. Në DPV/2008 subjekti ka deklaruar zyrë me sip. 74.5 m², e paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, bulevardi “****”, me kontratë shitblerjeje (premtim shitjeje) nr. ****, datë 15.6.2008, me vlerë 8.900.000 lekë, me burim krijimi: (i) kursime familjare ekzistuese të deklaruara në ILDKPKI; (ii) të ardhurat e fituara deri në momentin e kontratës; si dhe (iii) hua nga persona fizikë (të afërm dhe miq të deklaruar në të dhënat konfidenciale).

11.2. Si burim krijimi për këtë pasuri të paluajtshme, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*:

- i) të ardhurat nga puna e bashkëshortit për vitet 2006, 2007 dhe 2008;
- ii) gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortit në vlerën 9.000 euro;
- iii) gjendje *cash* krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, paguar nëpërmjet derdhjes në bankë në llogari të bashkëshortit në shumën 21.000 euro;
- iv) huamarrje në shumën 10.000 euro, veprimi nëpërmjet bankës, datë 30.5.2008, me huadhënës K. Ç.;
- v) huamarrje në shumën 21.000 USD dhe 13.800 euro (në total afërsisht 25.000 euro), me huadhënës A. K.;
- vi) huadhënie në shumën 7.980 GBP (afërsisht 10.000 euro), me huadhënës A. M.

Në lidhje me gjendjen në llogarinë bankare të personit të lidhur në shumën 9.000 euro

a) *Gjendja e llogarisë së bashkëshortit deri në datën 21.5.2008 – shuma 9.072 euro*

11.3. Kjo shumë e ka burimin nga shuma 10.000 euro e depozituar në datën 19.7.2006 në llogarinë bankare të deklaruar si kursime familjare në DPV/2006, me gjendje në vlerën 8.000 euro.

11.4. Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të vlerës 10.000 euro në datën 19.7.2006, e cila në DPV/2006 deklarohet si kursime familjare të krijuara nga të ardhurat e anëtarëve të familjes në Bankën Amerikane. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti) nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për depozitim bankar në datën 19.7.2006 të shumës 10.000 euro dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, në vlerën -205.089 lekë.

b) *Në lidhje me gjendjen cash të krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, paguar nëpërmjet derdhjes në bankë në llogari të tij në shumën 21.000 euro dhe të ardhurat nga puna e bashkëshortit për vitet 2006, 2007 dhe 2008*

11.5. Në lidhje me kursimet familjare të derdhura nga bashkëshorti në datën 12.6.2008, Komisioni analizoi kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshorti i saj deri në vitin 2008 dhe në referim të analizës së deklaramëve periodike vjetore rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kanë deklaruar vetëm gjendje *cash* në vitet 2004 - 2005 në vlerë progresive prej 1.400.000 lekësh. Në vitet 2006 dhe 2007 nuk është deklaruar shtesë në kursimet *cash* nga ana e bashkëshortëve.

11.6. Sipas rezultatit negativ të analizës financiare të vitit 2004, subjekti rezulton në pamundësi financiare për krijimin e këtyre kursimeve në shumën 600.000 lekë.

11.7. Meqenëse viti 2005 ka një rezultat pozitiv, mundësia e shtimit të kursimeve në këtë vit në vlerën 800.000 lekë u konsiderua si burim i ligjshëm për krijimin e gjendjes *cash*.

11.8. Sa më sipër, nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të vlerës së depozituar prej 21.000 euro në datën 21.5.2008, për sa kohë që nga hetimi administrativ rezultoi e provuar vetëm mundësia financiare e kursimit të gjendjes *cash* në vitin 2005, në vlerën 800.000 lekë.

Analiza financiare e mundësisë së depozitimit të shumës 21.000 euro, në datën 21.5.2008

Analiza financiare në datën 21.5.2008	Vlera
Kursime <i>cash</i> të deklaruara, provuar lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit	800,000
Të ardhura totale	800,000
Depozituar nga L. K.	2,586,833
Pamundësia financiare për depozitimin e shumës 21,000 euro	(1,786,833)

11.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës, për sa dukej se subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime financiare të ligjshme për depozitimin e shumës 10.000 euro, në datën 19.7.2006 dhe për depozitimin e shumës 21.000 euro, në datën 21.5.2008, në vlerën financiare negative prej 1.786.833 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me pagesën e kështit të parë prej 30.000 euro

11.10. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Kësti i parë prej 30.000 euro, që përbëhet nga 9.000 euro kursime bankare tek ‘Intesa Sanpaolo Bank’ dhe 21.000 euro nga kursimet cash dhe të ardhura familjare dhe biznesi i bashkëshortit. Lidhur me mundësinë e krijimit të depozitës prej 10.000 euro në vitin 2006 nuk janë konsideruar drejt nga Komisioni shpenzimet e arsimimit të djalit. Vlera e mbetur e detyrimit të deklaruar në vitin 2005 nuk është shpenzim mujor. Kjo redukton shpenzimet e arsimit në mënyrë të ndjeshme, duke nxjerrë një mundësi financiare për krijimin e depozitës prej 10.000 euro në vitin 2006.*

*Ndërsa lidhur me mundësinë e depozitimit të vlerës 21.000 euro, në datën 21.5.2008, nga L. K., në analizë financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga punësimi i pretenduar i bashkëshortit tek shoqëria ‘***’ sh.a. Si burim i ligjshëm për blerjen e kësaj zyre kanë shërbyer edhe kursimet cash të deklaruara në DPV/2004, në vlerën 600.000 lekë. Këto kursime që në vitin 2003, por gabimisht nuk i kam deklaruar.*

*Të ardhura të tjera që duhen marrë në konsideratë janë të ardhurat nga *** dhe *** në vitin 2004, të cilat Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare. Nëse këto të ardhura do të përfshiheshin në analizë, rezultati financiar i vitit 2004 do dilte pozitiv, duke ligjësuar edhe kursimin e deklaruar prej 600.000 lekësh”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin

11.11. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar nga hetimi administrativ, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e subjektit në seancë, arsyeton se:

11.12. Në vlerësim të provave dhe fakteve, si dhe deklaratimeve të subjektit në prapësimet e saj, pas kalimit të barrës së provës lidhur me depozitimin e vlerës 10.000 euro, në datën 19.7.2006, nga bashkëshorti, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi rishikimin e analizës financiare, duke konsideruar rilogaritjen e shpenzimeve dhe arsimimit të djalit në vitin 2006, është i drejtë dhe duhet të pranohet.

11.13. Ky rishikim redukton shpenzimet e arsimit për djalin e subjektit dhe, për rrjedhojë, redukton edhe diferencën negative të rezultuar në rezultatet e hetimit në vlerën 205.089 lekë për periudhën deri kur është kryer depozitimi bankar i shumës 10.000 euro, në datën 19.7.2006.

11.14. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare në datën 19.7.2006 për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të krijuar gjendje në llogaritë bankare në vlerën 10.000 euro dhe për shpenzime të tjera.

11.15. Për sa më sipërarsyetuar, vlera e kësaj depozite prej 9.000 euro u përfshi si burim i ligjshëm në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni për blerjen e pasurisë së paluajtshme zyrë në vitin 2008 nga subjekti dhe bashkëshorti.

c) Lidhur me depozitimin e vlerës 21.000 euro, në datën 21.5.2008 nga bashkëshorti i subjektit

11.16. Në vlerësim të provave dhe fakteve, si dhe deklaratimeve të subjektit në prapësimet e saj pas kalimit të barrës së provës lidhur me depozitimin e vlerës 21.000 euro, në datën 21.5.2008, nga bashkëshorti, Komisioni analizoi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kursimet *cash* të viteve të mëparshme dhe të ardhurat e vitit 2008 deri në datën e depozitimit të kësaj shume, duke arsyetuar si vijon:

- *Lidhur me gjendjen cash të deklaruar në vitin 2004*

11.17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kursimet *cash* të deklaruara në DPV/2004 në vlerën 600.000 lekë ekzistonin që në vitin 2003, por gabimisht nuk janë deklaruar prej saj.

11.18. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë që subjekti nuk e ka deklaruar këtë kursim në deklaratën periodike të vitit 2003. Në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2003 është provë që rrëzon pretendimet e subjektit në proces për gjendjen *cash* në vitin 2003.

11.19. Subjekti, gjithashtu, lidhur me të ardhurat e kursyera në vitin 2004, pretendon marrjen në konsideratë në analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit nga shoqëritë “***” dhe “***”.

11.20. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të vitit 2004 vlerën e provës, në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile e çmoi atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli.

11.21. Subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj në DPV/2004 nuk kanë deklaruar të ardhura nga shoqëritë e sipërcituara.

11.22. Shuma e deklaruar si e përfituar nga këto shoqëri nuk është deklaruar nga subjekti si e ardhur në deklaratën *Vetting*, sipas detyrimit të udhëzimit datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së,

“Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, i cili në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: “7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj.”.

11.23. Mosdeklarimi i shumës së pretenduar në deklaratën *Vetting* dhe në deklarimin periodik vjetor u vlerësua nga trupi gjykues si provë për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit në raport me zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe i mjaftueshëm për t’u arritur në konkluzionin se këto të ardhura nuk duhet të merren në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të vitit 2004 të kryer nga Komisioni.

11.24. Ky konkluzion është arritur duke u mbështetur edhe në hetimin administrativ, ku nuk rezultoi asnjë dokumentacion ligjor provues që të vërtetojë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur marrëdhënie punësimi apo konsulence me këto shoqëri dhe nuk ka asnjë provë financiare se nga bashkëshorti janë përfituar shumat monetare lidhur me këto shërbime të pretenduara nga këto shoqëri. Vërtetimet e marra nga këto shoqëri, në funksion të procesit të rivlerësimit dhe gjatë tij, nuk përbëjnë provë për të vërtetuar pretendimet e subjektit, për sa ato nuk vijnë në harmoni me provat e tjera të analizuara më sipër.

11.25. Trupi gjykues vlerëson se në analizë të provave në tërësi me rrethanat e çështjes dhe duke i njohur vlerën e provës, deklaratës periodike të pasurisë së vitit 2004, subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e përfituara nga shoqëritë “***” dhe “****” në vitin 2004.

- *Lidhur me gjendjen cash të deklaruar në vitin 2005*

11.26. Trupi gjykues arsyeton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me llogaritjen e xhiros së biznesit të bashkëshortit në vitin 2005 nuk do të ndryshonin kursimet e deklaruara prej tyre për vitin 2005 në vlerën 800.000 lekë, e cila është marrë në konsideratë që në rezultatet e hetimit administrativ.

- *Lidhur me të ardhurat e pretenduara në vitin 2008*

11.27. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga punësimi i pretenduar i bashkëshortit tek shoqëria “****” sh.a.

11.28. Trupi gjykues i dha DPV/2008 vlerën e provës, në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, duke e çmuar atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli dhe vëren se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga kjo shoqëri për vitet 2007 - 2008.

11.29. Përfitimi i të ardhurave nga kjo shoqëri nuk është deklaruar nga subjekti si e ardhur as në deklaratën *Vetting*, sipas detyrimit të udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, i cili në pikat 7, 15, 18 dhe 22 përcakton: “7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj.”.

11.30. Nga hetimi administrativ rezultoi dokumentacion ligjor provues që vërtetonte se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur marrëdhënie konsulence me këtë shoqëri dhe rezultoi gjithashtu se ka provë financiare derdhjeje në llogarinë bankare të bashkëshortit nga kjo shoqëri, si dhe të ardhura të përfituara prej tij në formën e çekut bankar nga kjo shoqëri.

11.31. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, së bashku me provat e tjera në tërësi me rrethanat e çështjes, trupi gjykues, lidhur me këto të ardhura, arsyeton si vijon:

11.32. Lidhur me vlerën e përfituar nga kjo shoqëri nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2007, këto të ardhura janë shpenzuar brenda këtij viti kalendarik nga subjekti dhe bashkëshorti, për sa në DPV/2007 nuk është deklaruar gjendje *cash* si kursim nga të ardhurat, duke i dhënë deklaratës së vitit 2007 vlerën e provës në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile e çmoi atë me rëndësi provuese për pasurinë objekt kontrolli.

11.33. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga kjo shoqëri në vitin 2008, Komisioni vlerësoi të konsiderojë si të ardhura të ligjshme të provuara nga hetimi administrativ të ardhurat e përfituara nga kjo shoqëri të provuara me transaksionet bankare të kryera nga kjo shoqëri në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Vlera e të ardhurave të kaluara me bankë nga llogaria e shoqërisë “****” sh.a. te llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga fillimviti 2008 deri në maj të vitit 2008, kur është bërë edhe depozitimi në bankë i shumës 21.000 euro, gjithsej 236.568 lekë.

11.34. Për sa më sipërarsyetuar, vlera prej 236.568 lekësh u përfshi si burim i ligjshëm në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni për mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit për depozitim të kryer në shumën 21.000 euro, në datën 21.5.2008.

11.35. Lidhur me të ardhurat e tjera të pretenduara si të përfituara nga kjo shoqëri nëpërmjet çeqeve bankare, trupi gjykues është njohur me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këto të ardhura dhe me provën e paraqitur prej saj me anë të shkresës datë 8.11.2022, të “Credins Bank”, e lidhur me interpretimin ligjor mbi vlefshmërinë e çekut si mjet pagese, por vlerëson të nënvizojë se të ardhurat e përfituara me çek nga shoqëria “****” sh.a. datojnë pas datës 21.5.2008, datë kur u depozitua shuma 21.000 euro, prandaj nuk mund të merren në konsideratë lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit lidhur me mundësinë financiare të tyre për këtë depozitim.

11.36. Në analizë të provave gjatë hetimit administrativ dhe pas shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti dhe bashkëshorti nuk arritën të provojnë se kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për depozitim të shumës 21.000 euro, në datën 21.5.2008 dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës, duke rezultuar në pamundësi financiare në vlerën prej 743.929 lekësh.

11.37. Për sa më sipërarsyetuar, vlera prej 21.000 euro nuk u përfshi si burim i ligjshëm në analizën financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni për blerjen e pasurisë së paluajtshme zyre në vitin 2008 nga subjekti dhe bashkëshorti.

Në lidhje me huan e marrë nga z. A. K. në vlerat 21.000 USD dhe 11.864 euro

11.38. Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 22.4.2015, subjekti ka deklaruar si burim për huan e marrë nga shtetasi A. K. të ardhurat nga puna si emigrant në Mbretërinë e Bashkuar dhe kursime nga puna e tij si punonjës i Bankës Amerikane.

11.39. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ILDKPKI-ja në kuadër të deklaratës *Vetting* rezulton se: “Në datën 12.6.2008, A. K., transferon për llogari të A. K. shumën prej 21.000 USD, me përshkrimin ‘shlyerje detyrimi’ dhe në datën 13.6.2008, A. K. depoziton shumën prej 3.000 GBP, në llogari të bashkëshortit të subjektit me përshkrimin ‘dhënie huaje’”.

11.40. Në procesverbalin mbi shpjegime të subjektit deklarues mbajtur në ILDKPKI, datë 24.11.2011, subjekti është pyetur se në DPV/2010 ka deklaruar se ka shlyer detyrimin financiar ndaj huadhënësit A. K. Subjekti ka deklaruar para ILDKPKI-së se shumën prej 1.000.000 lekësh ia ka dhënë *cash* huadhënësit A. K. dhe për shumën 500.000 lekë kanë rënë dakord të likuidohen nëpërmjet huas së dhënë më parë në shumën 5.000 USD.

11.41. Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi A. K. është analizuar mundësia e huadhënësit që me të ardhurat nga emigracioni dhe ato nga puna tek “Intesa Sanpaolo Bank”, t’i japë hua bashkëshortit të subjektit, si dhe të përballojë shpenzimet e jetesës. Referuar përgjigjes nga “Intesa Sanpaolo Bank”, për llogaritë në emër të z. A. K., është analizuar gjendja e këtyre llogarive dhe mundësia e këtij shtetasi për të krijuar këto gjendje llogarish dhe për huan dhënë z. L. K.

11.42. Nga informacioni i administruar nga “Intesa Sanpaolo Bank” ka rezultuar se shtetasi A. K., në datën 13.6.2008, pas dhënies së huas vëllait të tij L. K. ka pasur gjendje në llogaritë bankare të tij shumën 1.316.693 lekë. Në analizën financiare të mundësisë së huadhënies së vlerës së deklaruar më sipër është marrë në konsideratë edhe kjo gjendje likuiditetesh.

11.43. Analiza financiare lidhur me mundësinë e huadhënësit u krye duke filluar nga data 10.4.2001 për sa të ardhurat financiare të këtij huadhënësi deri në këtë datë janë përfshirë në analizën e mundësinë financiare të blerjes së pasurisë apartament në emër të shtetasit H. K. në vitin 2001.

11.44. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni duket se shtetasi A. K. nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për huadhënien bashkëshortit të subjektit, mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shtimin e likuiditeteve në bankë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për sa dukej se huadhënësi A. K. nuk kishte burime financiare të ligjshme për huadhënien në vlerat 21.000 USD dhe 11.864 euro, të cilat kanë shërbyer për pagesën e kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me huadhënien nga shtetasi A. K.

11.45. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: “Z. A. K. i kishte gjendje këto shuma prej vitesh dhe në vitin 2008 ia dha hua vëllait të tij. Burimi i krijimit të këtyre shumave ishin: (i) të ardhurat nga puna në emigracion; (ii) të ardhurat e tij nga puna në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ nga prilli 2005 e në vijim.

*Të ardhurat neto totale, për të cilat vërtetohet pagesa e tatimeve për periudhën e emigracionit, janë 38.069,1 GBP, e përbërë nga: punësimi në ‘****’, 26 maj - 7 gusht 2003; të ardhura nga një punësim i shkurtër në agjencinë e punësimit ‘***’, periudha përpara punësimit në ‘****’, vërtetuar me urdhërpagesat përkatëse gjithsej 548,4 GBP; të ardhura të tjera nga punësimi i pjesshëm në një agjenci imobiliare me pronar D. B., të ardhura paguar cash, për të cilat nuk janë ruajtur dokumentet.*

*Në lidhje me shpenzimet e jetesës, z. A. K., për 6-mujorin e parë të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar (shtator 1999 - shkurt 2000), shpenzimet e jetesës janë mbuluar nga shteti anglez, pasi ai nuk ishte i pajisur me leje pune, sipas ligjit, duke i siguruar strehim, ushqim, nevojat shëndetësore dhe arsimim falas. Për periudhën në vijim, me pajisjen me leje pune, z. A. K. deklaroi se ka hequr dorë nga përfitimet sociale, duke u spostuar nga banesa e sipërcituar në adresë tjetër ku banonte motra e tij. Qëndrimi te motra ka qenë vetëm për fjetje, pasi në këtë kohë ka qenë i punësuar në hotelin ‘****’, një hotel luksoz me 5 yje, në të cilin ushqimi ka qenë pjesë e trajtimit të stafit.*

Në analizën financiare të raportit janë evidentuar gjendjet e llogarive bankare të z. A. K. në momentin e dhënies së huas, ku rezulton se pas dhënies së huas gjendja është 1.316.693 lekë. Këto gjendje llogarie kanë si burim jo vetëm të ardhurat nga puna të z. A. K., por edhe nga të ardhura nga interesat – depozitimin nga znj. L. K. në vlerën 5.000 USD. Shtesa e llogarisë nga z. L. K. në formë huaje në vlerën 5.000 USD në vitin 2004.

Kursi zyrtar i llogaritur nga Komisioni duhet të jetë kursi mesatar për muajin qershor 2008, në të cilën ka ndodhur transaksioni dhe jo kursi mesatar i muajit dhjetor, siç është përdorur në analizë”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.46. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancat dëgjimore, arsyeton se:

11.47. Subjektet e rivlerësimit mbartin detyrimin që për secilën pasuri të deklarojnë burimin e krijimit në momentin e krijimit të tyre, sipas përcaktimeve në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 7 të udhëzimit datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

11.48. Komisioni vlerësoi të analizojë të gjithë marrëdhënien e deklaruar nga subjekti lidhur me huat e marra nga vëllai i bashkëshortit të saj.

11.49. Në deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 25.10.2004, z. A. K. ka deklaruar se me të ardhurat e tij të fituara nga puna në emigracion në Mbretërinë e Bashkuar ka blerë apartamentin në rrugën “****” në vitin 2001, apartament i trajtuar më lart në këtë vendim në të cilin kanë jetuar në mënyrë të pandërprerë subjekti dhe bashkëshorti.

11.50. Në vijim, nga hetimi administrativ ka rezultuar se në vitin 2003 në llogarinë e z. L. K., në GBP, në ish-Bankën Amerikane, të hapur më 16.4.2003, rezulton transfertë nga Mbretëria e Bashkuar në vlerën 8.000 GBP në datën 2.5.2003 dhe, në vijim, një depozitim *cash* i kryer nga bashkëshorti i subjektit L. K., në vlerën 10.200 GBP në datën 21.8.2003. të cilat në datë 6.5.2004 u transferuan në vlerën 18.743,88 GBP tek llogaria e z. A. K.

11.51. Në vitin 2005 bashkëshorti i subjektit L. K. deklaroi në deklaratimin periodik dhënien e huas vëllait të tij, z. A. K., në vlerën 5.000 USD.

11.52. Komisioni së pari analizoi mundësinë financiare të huadhënësit z. A. K., që pas kontributit të tij dhënë në blerjen nga babai i tij të shtëpisë në rrugën “****”, të krijonte nga emigracioni deri në vitin 2003 shumat e dhëna hua bashkëshortit të subjektit.

11.53. Në këtë analizë financiare janë pasqyruar pretendimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës lidhur me të ardhura shtesë për vitin 2003 nga punësimi në “****” për periudhën prill – gusht 2003, vërtetuar me dokumentacion provues, të sjella pas kalimit të barrës së provës, të cilat u përfshinë në analizën përfundimtare financiare të mësipërme si të ardhura të ligjshme të huadhënësit.

11.54. Subjekti i rivlerësimit pretendoi pas kalimit të barrës së provës se personi tjetër i lidhur, z. A. K., kishte shpenzime jetese më të ulëta në Mbretërinë e Bashkuar. Trupi gjykues arsyeton se për sa këto pretendime nuk u arritën të vërtetohen me dokumentacion ligjor provues ato ngelen vetëm në nivel deklarativ.

11.55. Analiza financiare e kryer lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit A. K. për të krijuar të ardhurat e dhëna hua nga punësimi i tij në emigracion rezultoi si vijon:

Analiza financiare për periudhën prill 2001 - gusht 2003	Vlera në lekë
Të ardhura <i>neto</i> A. K., Mbretëri e Bashkuar prill 2001 – gusht 2003	2,358,339
Llogari 18,200 GBP	3,456,544
Llogari bankare 3,291 USD	357,699
Pamundësia financiare	-1,455,904

11.56. Trupi gjykues arriti në përfundimin se huadhënësi A. K. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar me të ardhurat nga emigracioni likuiditetet bankare, pasi ka rezultuar për periudhën prill 2001 – gusht 2003 me një pamundësi financiare në vlerën 1.455.904 lekë.

11.57. Komisioni, së dyti, ka analizuar edhe mundësinë e huadhënësit A. K., duke analizuar të ardhurat e tij nga punësimi në Shqipëri për periudhën 2005 – maj 2008, duke marrë në konsideratë në analizën financiare të kësaj periudhe të ardhurat shpenzimet jetike për një person, si dhe likuiditetet bankare të krijuara nga z. A. K. gjatë kësaj periudhe.

11.58. Pas analizimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me pretendimin se pjesë e likuiditeteve në emër të z. A. K. ishte edhe depozitimi i bërë nga motra e tij L. K., në datën 3.8.2006, në vlerën 5.000 USD, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit duhet të pranohet për arsyen se referuar hetimit ka rezultuar se këta shtetas kanë llogari të përbashkëta me përafërsi në vlerën 1.100.000 lekë deri në momentin e huadhënies.

11.58.1. Referuar legjislacionit bankar, të dy mbajtësit e llogarisë apo të depozitës prezumohet se janë bashkëzotërues të fondeve të këtyre llogarive dhe kanë të njëjtën mundësi për pranim apo dërgim mjetesh monetare përmes depozitimeve, tërheqjeve dhe transfertave të këtyre fondeve të përbashkëta. Kjo vlerë e përafërt me pjesën takuese të motrës së huadhënësit në llogaritë bankare u vlerësua nga trupi gjykues të zbritet nga vlera e likuiditeteve të huadhënësit.

11.58.2. Gjithashtu, u mor në konsideratë edhe huaja e dhënë nga bashkëshorti i subjektit L. K. vëllait të tij A. K. në vitin 2005.

11.59. Analiza përfundimtare lidhur me mundësinë e huadhënësit A. K. mbi të ardhurat e tij nga punësimi në Shqipëri për periudhën 2005 – maj 2008, rezultoi si vijon:

Analiza financiare për periudhën 2005 – maj 2008	Vlera
Të ardhura <i>neto</i> nga puna 2005 – maj 2008	1,881,467
Huadhënie L. K. 5,107 USD - 2005	532,313
Shpenzime A. K. 1 person gusht 2003 – 13.6.2008	551,467
Likuiditete në bankë, datë 13.6.2008	919,843
Huadhënie subjektit 21,000 USD	1,666,770
Huadhënie subjektit 11,864 euro	1,446,815
Pamundësi financiare	- 2,171,115

11.60. Nga analiza financiare përfundimtare e mësipërme rezulton se nga të ardhurat nga punësimi në Shqipëri, huadhënësi A. K. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar likuiditetet bankare dhe likuiditetet e dhëna hua, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën 2.171.115 lekë.

11.61. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë e personit tjetër të lidhur, shtetasit A. K., për të mbuluar me burime të ligjshme huan në vlerat 21.000 USD dhe 11.864 euro, dhënë bashkëshortit të subjektit në vitin 2008.

11.61.1. Komisioni vlerësoi se këto të ardhura nuk duhet të përfshiheshin në analizën përfundimtare financiare të mundësisë së blerjes së pasurisë zyrë me sip. 74.5 m², në vitin 2008.

Lidhur me huan e marrë nga shtetasi K. Ç. në vlerën 10.000 euro

11.62. Subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting* se burim i kësaj huaje kanë qenë të ardhurat e huadhënësit K. Ç. nga aktiviteti i tij privat, pasi është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k.

11.63. Ky huadhënës ka kaluar në llogarinë e z. L. K., më 30.5.2008, shumën 10.000 euro, sipas aktmarrëveshjes datë 5.6.2008, midis av. L. K. dhe z. K. Ç.

11.64. Në këtë aktmarrëveshje palët bien dakord që shuma 10.000 euro, e dhënë hua, do të konsiderohet e shlyer nëpërmjet shërbimit të avokatisë që do të kryhet nga z. L. K. kundrejt shtetasit K. Ç. nga shoqëria “***” sh.p.k., për vitin 2008 do të konsiderohet e likuiduar shuma 3.500 euro, ndërsa për vitin 2009 shuma 6.500 euro.

11.65. Drejtoria Vendore e Tatimeve Tiranë informon Komisionin se z. K. Ç. është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., e regjistruar në sistemin tatimor më 11.3.2005 me aktivitet në fushën e ndërtimit, si dhe nuk konfirmon shpërndarje dividendi nga ana e shoqërisë.

11.66. Kjo shoqëri ka qenë e regjistruar në DRT Tiranë si filial i degës së Tatimeve Elbasan. Qendra Kombëtare e Biznesit informon ILDKPKI-në se shtetasi K. I. Ç. është administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “***” sh.p.k.

11.67. Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 22.4.2015, subjekti, në lidhje me burimin e huave të huadhënësve, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Huadhënësi K. Ç. është mik dhe klient i bashkëshortit. Ai ushtron aktivitet privat dhe zotëron shoqërinë tregtare ‘***’ sh.p.k., shumën e dhënë hua e ka krijuar nga aktiviteti i tij tregtar”*.

11.68. Sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës të shpjegojë dhe provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme të huadhënësit K. Ç., për huan në shumën 10.000 euro të dhënë në vitin 2008.

Qëndrimi i subjektit lidhur me huan në vlerën 10.000 euro nga shtetasi K. Ç.

11.69. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: *“Kur bashkëshorti mendoj të blej zyrë me sip. 74.5 m² shitësi emigronte për në SHBA dhe bankat vononin për aplikimin për kredi. Z. K. Ç., ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., ka depozituar shumën 10.000 euro në llogarinë bankare të bashkëshortit, shumë të cilën me marrëveshjen e datës 5.6.2008 do të shlyhej nëpërmjet shërbimeve të përfaqësimit”*.

*Në përgjigje të kërkesës së drejtuar në këtë cilësi me shkresën e datës 17.10.2022, shoqëria tregtare ‘***’ sh.p.k., përfaqësuar nga z. K. Ç., ortak i vetëm dhe administrator i saj sqaron se: ‘Për shkak të përfaqësimit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. kam kryer një pagesë në formë*

*parapagimi për shërbimet që do të kryenit për llogari të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. në shumën totale 10.000 euro, pagesë kjo e kryer në rrugë bankare. Shuma e depozituar ka si burim të ardhurat nga shoqëria tregtare ‘***’ sh.p.k., ka arkëtuar në bazë të kontratave të sipërmarrjes që lidhte me blerës të ndryshëm, në objektin ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, miratuar nga Bashkia Tiranë në rrugën ‘***’. Bashkëlidhur vihen në dispozicion kontratat e cituara dhe mandatarkëtimet përkatëse”.*

Shpërndarja e dividendit të shoqërisë tregtare ndjek një procedurë tërësisht të posaçme, ai përbën një akt vullneti të ortakëve të saj dhe kushtëzohet nga lëshimi i certifikatës së aftësisë paguese nga administratori.

*Nëpërmjet një kontrate kredie datë 7.5.2007, shtetasi K. Ç. dhe bashkëshortja e tij kanë marrë kredi në ‘Tirana Bank’, datë 11.5.2007 dhe në datën 14.5.2007 kanë tërhequr shumën 50.000 euro. Si në cilësinë e administratorit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., si në cilësinë si individ, shtetasi K. Ç. dhe bashkëshortja e tij kanë mundësi për dhënien e huas në shumën 10.000 euro bashkëshortit”.*

11.70. Në lidhje me të ardhurat nga kontrata e kredisë datë 7.5.2007, si burim i ri për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit, Komisioni konstaton se ky burim nuk është deklaruar më parë nga subjekti, pra ajo ka ndryshuar/shtuar burimin e të ardhurave për huan e dhënë pas dërgimit të rezultateve të hetimit, prandaj vlerëson që ky burim i ri të mos merret në konsideratë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.71. Subjekti pretendon se vlera e marrë hua nga ky shtetas buron nga paratë e marra nga huadhënësi sipas kontratave të porosive për punime të ndryshme nga klientët e biznesit të tij, por nga analizimi i pasqyrave financiare nuk vërtetohet shpërndarje dividendi dhe as huamarrje të ortakut nga shoqëria. Si rrjedhim, kjo hua e pretenduar nuk mund të përfshihet në burimet e ligjshme të pagesës së pasurisë.

11.72. Komisioni vlerëson se në kushtet kur shpërndarja e dividendit në shoqërinë tregtare kryhet mbi një vendim të ortakut të shoqërisë, i cili ka detyrim ligjor depozitimin e këtyre vendimeve pranë organeve tatimore dhe organi përgjegjës tatimor nuk ka të dokumentuar/administruar dhe nuk ka përcjellë pranë Komisionit vendime përkatëse të ortakut të shoqërisë të vetmet dokumente ligjore të shoqërisë mbi bazë të të cilave miratohen rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe caktohet destinacioni i fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi, janë pasqyrat financiare, të cilat nuk provojnë një fakt të tillë.

11.73. Subjektit iu kalua barra e provës të shpjegojë dhe provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme të huadhënësit K. Ç., për huan në shumën 10.000 euro, të dhënë në vitin 2008 dhe nga ana e saj nuk u soll asnjë dokumentacion ligjor provues lidhur me shpërndarjen e dividendit nga kjo shoqëri. Në seancën dëgjimore subjekti depoziton në cilësinë e provës një kontratë kredie të lidhur midis “Tirana Bank” dhe shtetasve E. dhe K. Ç. në vlerën 50.000 euro, të marrë për arsye personale në maj të vitit 2007. Kjo provë sillet me pretendimin se huadhënësi si individ ka pasur mundësi për të dhënë huan e pretenduar (10.000 euro).

11.74. Ky pretendim i ri i subjektit nuk është përmendur më parë, ndërkohë që si burim i huadhënies ishte deklaruar aktiviteti privat i z. K. Ç.

11.75. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është bindëse në shpjegimet dhe provat e depozituara, duke mos arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të

hetimit, kjo në këndvështrimin edhe të ndryshimit të deklarimeve lidhur me të ardhurat e huadhënësit, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i shumës së dhënë hua.

11.76. Si rrjedhim, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur K. Ç. nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar shumën e dhënë hua në vlerën 10.000 euro në favor të subjektit të rivlerësimit.

11.76.1. Komisioni vlerësoi se këto të ardhura nuk duhet të përfshiheshin në analizë përfundimtare financiare të mundësisë së blerjes së pasurisë zyre me sip. 74.5 m² – viti 2008.

Lidhur me huan e marrë nga z. A. M. në vlerën 7.980 GBP (afërsisht 10.000 euro)

11.77. Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, datë 22.4.2015, subjekti, në lidhje me burimin e huave të huadhënësve, ndër të tjera, ka deklaruar se: “A. M. është dhëndri i motrës së bashkëshortit tim. Burimi i huas së tij janë të ardhurat nga puna dhe kursimet e tij familjare”.

11.78. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A. M., subjekti ka depozituar pranë Komisionit një vërtetim në gjuhën angleze nga ***, në cilësinë e punëdhënësit të huadhënësit A. M., i cili informon se z. A. M. është i punësuar në kohë të plotë nga gushti i vitit 2006 deri në nëntor të vitit 2009. Ky vërtetim nuk është në formën e kërkuar nga ligji², i paapostiluar, nuk është përkthyer dhe noterizuar, si dhe nga përmbajtja nuk vërteton sa janë të ardhurat.

11.79. Me shkresën e datës 16.10.2020, të shoqërisë “***”, bazuar në të dhënat e sigurimeve kombëtare vërtetohet se të ardhurat e z. A. M. rezultojnë të ardhura nga punësimi vetëm për vitin 2008, të cilat sipas analizës së mëposhtme janë të pamjaftueshme për mbulimin e vlerës së deklaruar si hua në vlerën 10.000 euro bashkëshortit të subjektit.

11.80. Nga analiza financiare duket se huadhënësi A. M. kishte të ardhura në shumën 6.264 GBP dhe, si rrjedhim, nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua 7.980 GBP bashkëshortit të subjektit në datën 28.5.2008.

11.81. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.82. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se: “Lidhur me huan nga z. A. M. depozitohet nga Mbretëria e Bashkuar dokumente të apostiluara, që vërtetojnë të ardhura nga motra e tij A. M., e cila punon në policinë e Londrës. Kur jam pyetur në ILDKPKI në datën 22.4.2015, në lidhje me burimin e kësaj huaje kam deklaruar se A. M. është dhëndri i motrës së bashkëshortit tim, burimi i kësaj huaje janë të ardhurat e siguruar nga puna dhe kursimet e tij familjare”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.83. Komisioni, pasi administroi DPV/2008 dhe provat e tjera, vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të huadhënësit as në deklaratën *Vetting* as në këtë DPV.

11.84. Pretendimet e subjektit se burimi i huas të z. A. M., i cili ishte i fejuari i vajzës së motrës së bashkëshortit të subjektit, kishte përdorur edhe të ardhurat e motrës së tij në Mbretërinë e

²Neni 266 i Kodit të Procedurës Civile shkresa në gjuhë të huaj: “Kur shkresa është në gjuhë të huaj ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent”.

Bashkuar për të mundësuar blerjen nga ana e bashkëshortit të subjektit të një ambienti zyre nuk janë bindëse për trupin gjykues.

11.85. Si rrjedhim, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur, z. A. M., nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar shumën e dhënë hua në vlerën 7.980 GBP (afërsisht 10.000 euro) në favor të subjektit të rivlerësimit.

11.86. Komisioni vlerësoi se këto të ardhura nuk duhet të përfshiheshin në analizë përfundimtare financiare të mundësisë së blerjes së pasurisë zyrë me sip. 74.5 m² – viti 2008.

Analiza financiare e mundësisë së blerjes së pasurisë zyrë me sip. 74.5 m² – viti 2008

Përshkrimi	Vlera
Hua nga A. K. 21,000 USD + 11,864 euro	-
Hua nga K. Ç. 10,000 euro	-
Hua nga A. M. 7,980 GBP	-
Depozita tek “Intesa Sanpaolo Bank” 9,000 euro	1,099,170
Kursime <i>cash</i> nga vitet e mëparshme	800,000
Të ardhura nga pagat e bashkëshortit tek shoqëria “****” sh.a. 1.1.2008 - 21.5.2008	236,568
Të ardhura nga pagat, subjekti 1.1.2008 - 21.5.2008	322,597
Të ardhura nga aktiviteti bashkëshorti 1.1.2008 - 21.5.2008	798,333
Të ardhura totale	3,256,668
Shpenzime jetese 1.1.2008 - 21.5.2008	153,698
Shpenzime arsimimi	183,000
Paguar për apartamentin 21,000 USD, datë 12.6.2008	1,666,770
Paguar për apartamentin 30,000 euro, datë 21.5.2008	3,663,900
Paguar për apartamentin 32,350 euro, datë 13.6.2008	3,945,083
Paguar në total për apartamentin dhe shpenzime të tjera	9,612,450
Pamundësia financiare për blerje apartamenti	-6,355,782

Sa më sipërrsyetuar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshorti nuk arritën të provonin burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën 6.355.782 lekë për krijimin e saj dhe duke u ndodhur në kushtet e pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me konfliktin e interesit

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.6.2022, informon Komisionin se subjekti ka gjykuar tri raste, në të cilat palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “****” sh.a. Vendimi nr. ***, datë 3.3.2015, me palë paditëse ***, i paditur shoqëria “****” sh.a. me objekt detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar në vlerën 7.747.182 lekë.

12.1. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e palës së paditur shoqëria “****” të paguajë në favor të palës paditëse shumën 1.500.000 lekë; vendimi nr. ***, datë 9.6.2016, me paditës H. S., i paditur shoqëria e sigurimit “****”, me objekt detyrimin e palës së paditur të paguajë shpërblimin e plotë të dëmit pasuror dhe jopasuror; vendimi nr. ***, datë 15.2.2017, me paditës A. S., i paditur shoqëria “****” sh.a., me objekt detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer dëmin material të mjetit dhe detyrimin për të paguar kamatëvonesat deri në ekzekutimin e vendimit.

12.2. Nga hetimi administrativ rezultoi se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka pasur marrëdhënie punësimi dhe/ose shërbimi me shoqërinë “****” sh.a. Në deklaratën *Vetting*, në formularin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura të bashkëshortit nga paga në shoqërinë ‘***’ sh. a. nëntor 2007 - qershor 2008. Çek nr. ***, datë 18.2.2009, nga ‘****’ sh.a. Çek nr. ***, datë 14.10.2010, nga ‘****’ sh.a. Çek me nr. ***, datë 19.9.2011, nga ‘****’ sh.a.*”. Personi i lidhur në deklaratën *Vetting*, përveç çeqeve të deklaruara nga subjekti, ka deklaruar edhe çekun me nr. ***, datë 12.6.2008, nga shoqëria “****” sh.a.

12.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka depozituar në Komision kërkesën datë 15.12.2020, drejtuar shoqërisë “****” sh.a.

12.4. Me kërkesën datë 15.12.2022, bashkëshorti i subjektit i drejtohet shoqërisë “****”. Me kërkesën si vijon: “*Me vendim të Këshillit të Mbikëqyrjes së shoqërisë (në muajin prill ose maj 2008), i cili ka miratuar dhënien e një shpërblimi të veçantë në favorin tim dhe jam shpërblyer në masën 2.000.000 lekë. Gjithashtu, në cilësinë e konsulentit ligjor kam bashkëpunuar suksesshëm për çështje të veçanta në ‘***’, në periudha kohore të tjera. Si rrjedhojë e punës dhe e rezultateve të saj jam shlyer me çek nga ana juaj dhe konkretisht në datat 12.6.2008, 29.8.2008, 18.2.2009, 14.10.2010, 30.11.2010, 16.9.2011 dhe 30.11.2010*”.

12.5. Komisioni, në vlerësim të fakteve, çmon se subjekti duhet të kishte dhënë dorëheqjen në gjykimin e këtyre çështjeve, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm³ për mosdhënien e garancive të nevojshme për një gjykim të paanshëm si një prej elementeve më esenciale të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykimin e paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.

12.6. Sa më sipër, duket se subjekti ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, në gjykimin dhe vendimmarrjen e çështjeve të relatuara më sipër.

12.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.8. Subjekti, ndër të tjera, pas kalimit të barrës së provës deklaroi se: “*Menjëherë pas marrjes së dosjes kam paraqitur kërkesën me objekt ‘Heqje dorë nga gjykimi i çështjes’ me shkakun se bashkëshorti im ka punuar për ‘***’ sh.a., atë kohë me emërtimin ‘***’ sh.a., për shkak të ndryshimit të pronësisë mbi aksionet dhe emërtimit të saj. Kryetari i Gjykatës, me vendimin e datës 30.1.2014, ka vendosur ‘Mospranim kërkesë’. Kërkesa për heqje dorë është refuzuar dhe, në këto kushte, kam vijuar gjykimin e çështjes. Për dy rastet e tjera janë padi të ngritura ndaj ‘***’ sh.a., regjistruar në gjykatë në kohë të paktën dy vjet më vonë përkatësisht: (a) padia me paditës: H. S.; i paditur ‘***’ sh.a. dhe objekt ‘shpërblim dëmi’. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 9.6.2016, ka vendosur ‘Pushimin e gjykimit të çështjes’; (b) padia me paditës A. S., i paditur ‘***’ sh.a., objekt ‘shpërblim dëmi’ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.2.2017, ka vendosur ‘Rrëzimin e padisë për shkak të*

³Neni 72/6 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “*Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie*”.

heqjes dorë nga e drejta e padisë'. Referuar fakteve të ndodhura rezulton se kam paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi nga çështja e parë dhe me vendim të kryetarit të gjykatës, kërkesa për heqje dorë nga gjykimi është refuzuar dhe, në këto kushte, kam vijuar gjykimin e saj. Për çështjet e regjistruara pas dy vitesh do të ishte e pavend dhe në mosrespektim të procesit të rregullt ligjor paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi për të njëjtin shkak për të cilin ajo ishte refuzuar dy vjet më parë dhe nga i njëjti kryetar gjykate. Përtej këtij aspekti, të dyja këto çështje të mëvonshme kanë përfunduar pa një vendim përfundimtar që zgjidh çështjen në themel, pasi paditësi është tërhequr nga procesi për shkak se e kishte zgjidhur mosmarrëveshjen jashtë gjyqësisht”.

Analiza ligjore në raport me provat dhe me ligjin e zbatueshëm

12.9. Trupi gjykues, pasi administroi provat e dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, provat e sjella nga subjekti dhe pasi dëgjoi përfaqësuesin e subjektit në seancë dëgjimore, vëren se subjekti ka depozituar në Komision, në cilësinë e provës, kërkesë për heqje dorë datë 30.1.2014, drejtuar kryetarit të gjykatës. Në përmbajtje të kërkesës citohet: *“Vite më parë bashkëshorti im ka punuar pranë ‘***’ sh.a. Megjithëse kompania ka ndryshuar pronësi për të shmangur çdo paragjykim mbi paanësinë time, çmuj se në referenca të neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile paraqes kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje”*. Me vendimin *“Mbi kërkesën për zëvendësim të gjyqtarit”* datë 30.1.2014, kryetari i gjykatës ka vendosur *“Mospranim të kërkesës”*, pasi nuk rezulton të jetë asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Komisioni vlerëson të marrë në analizë pretendimet e subjektit, duke hetuar në lidhje me ndryshimin e pronësisë së shoqërisë *“***”* sh.a. Nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit, Komisioni administroi ekstraktin historik të shoqërisë *“***”* sh.a., me NIPT ***** dhe konstatoi me depozitimin e datës 2.11.2011 blerjen e 75%+1 të aksioneve të shoqërisë *“***”* sh.a. nga shoqëria e huaj *“***”*, si dhe depozitimin e akteve përkatëse në lidhje me këtë transaksion të aksioneve të shoqërisë. Në dritën e këtyre fakteve të reja rezulton se personi i lidhur me subjektin kishte pasur marrëdhënie punësimi dhe/ose shërbimi me punëdhënësin shoqërinë *“***”* sh.a., e cila tashmë kishte ndryshuar ortakët e saj dhe 75% të aksioneve të kësaj shoqërie i përkisnin ortakut të ri personit juridik *“***”*, blerë më 2.11.2011. Në këtë kontekst, për shkak të ndryshimeve në aksionerin mazhoritar (shoqërinë e huaj *“***”*), marrëdhënia e interesit që mund ta vendoste subjektin në kushtet e konfliktit të interesit nuk ekziston më.

12.10. Sa më sipër, trupi gjykues, duke mbajtur si orientim edhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴, arrin në përfundimin se subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i çështjeve të sipërpërmendura, sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me këtë konstatim të Komisionit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, rekomandimin e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin dhe përfaqësuesin e saj ligjor në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, arrin në përfundimin se:

⁴Vendim nr. 8/2022 (JR), i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- a. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në lidhje me pasurinë apartament në përdorim, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, gjenden në situatën faktike të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
- b. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në lidhje me pasurinë njësi shërbimi zyrë kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke rezultuar me balancë negative në vlerën 6.355.782 lekë, duke u ndodhur në kushtet e pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- c. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në lidhje me pasurinë apartament banimi në Golem kanë deklarim të pasaktë sa i përket vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe kanë mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën 2.100.000 lekë për krijimin e kësaj pasurie duke u ndodhur në kushtet e pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- d. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të mos pranuar kërkesën e paraqitur gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore nga përfaqësuesi ligjor i subjektit, lidhur me çelje të hetimit administrativ për dy kriteret e tjera, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Teuta Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 22.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana